

Terme të Referencës

Organizata	HANDIKOS (Shoqata e Paraplegjikëve dhe Paralizës së Fëmijëve të Kosovës)
Tituli i angazhimit	Ekspert/Fasilitues për trajnimin “Përdorimi i medias në avokim”
Projekti:	<i>Promovimi i gjithëpërfshirjes dhe shtrirjes së proceseve konsultative për reformat e qeverisjes dhe administratës publike në sektorin e aftësisë së kufizuar në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal</i>
Implementuar nga:	HANDIKOS
Mbështetur nga:	Bashkimi European- Zyra në Kosovë
Qëllimi i angazhimit:	Trajnim “Përdorimi i mediave në avokim”
Lokacioni:	Prishtinë, Kosovë
Data e shpalljes:	18 Janar 2022
Data e mbylljes:	31 Janar 2022
Data e pritshme e fillimit:	04 Shkurt 2022
Personi/at kontaktues:	handikos@handi-kos.org

1. Prapavija

Në kuadër të projektit të financuar nga Bashkimi European “*Promovimi i gjithëpërfshirjes dhe shtrirjes së proceseve konsultative për reformat e qeverisjes dhe administratës publike në sektorin e aftësisë së kufizuar në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal*”, HANDIKOS synon të ngrisë kapacitetet e Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuara (OPAK-ët) në “Përdorimin e medias në avokim për operacionalizimin dhe financimin e zbatimit të legjislacionit”. Për të qenë në gjendje të përmbushin qëllimet dhe objektivat e organizatës, OPAK-ët duhet të rrisin aftësitë e tyre në përdorimin e mediave si një mjet i rëndësishëm në punën e tyre avokuese. Ky aksion do të bashkojë OPAK-ët për të zhvilluar shkathtësitë e përfaqësuesve dhe stafit të tyre që punojnë në avokim dhe promovimin e punës së organizatës së tyre.

2. Objektiva e angazhimit

Objektiva e përgjithshme e ekspertit do jetë zhvillimi i përmbajtjes së programit trajnues dhe ofrimi i trajnimit në “Përdorimin e medias në avokim” për OPAK, përgjatë vitit 2022.

3. Fushëveprimi

Zhvillimi dhe ofrimi i programit trajnues për OPAK:

- Shkathtësitë në “Përdorimin e medias në avokim” për OPAK;
- Draftimi i shabllonit të planeve të punës në media për OPAK;

- Programi trajnues do udhëhiqet nga eksperti në koordinim të ngushtë me ekipën e projektit të HANDIKOS dhe partnerët e projektit.

Eksperti do jetë përgjegjës për realizimin e detyrave të mëposhtme:

- Takim koordinues me ekipën e projektit lidhur me metodologjinë dhe përmbajtjen e trajnimit;
- Zhvillimi i programit trajnues 4 ditor dhe metodologjisë së trajnimit me fokus në natyrën e punës së OPAK/OJQ me media
- Fasilitimi dhe ofrimi i trajnimit sipas marrëveshjes me ekipën e HANDIKOS dhe partnerët e projektit;
- Dorëzimi i shabllonit dhe mbështetja e OPAK për draftimin e planeve të punës në media (2 ditë shqyrtim/hulumtim)
- Përgatitja e materialeve për pjesëmarrësit;
- Përgatitja e raportit.

4. Metodatat dhe Mjetet

Metodat e mëposhtme mund të përdoren për të kompletuar detyrat e lartpërmendura dhe përmbushjen e qëllimit të përcaktuar në TeR.

1. Takim koordinues me HANDIKOS dhe partnerët e projektit;
2. Draftimi i programit trajnues dhe prezantimit në Power Point
3. Trajnimi (4 ditë) për modulën "Përdorimi I medias në avokim" për përfaqësuesit e OPAK (HANDIKOS dhe partnerët e projektit);
4. Draftimi i shabllonit të planeve të punës në media për OPAK (2 ditë)

5. Kualifikimet, përvoja dhe shkathtësitë kyçe

Kandidati duhet të posedojë shkathtësitë dhe kompetencat e mëposhtme:

- Diplomë në Gazetari, Menaxhim i mediave, Komunikim, Zhvillim të organizatës apo fusha relevante
- Përvojë të gjerë pune në bashkëpunim/punë me sektorin e mediave, komunikimit apo marrëdhënieve me publikun në kuadër të OSHC-ve.
- Përvojë pune në planifikim dhe organizim të kampanjave avokuese dhe ngritjes së vetëdijes
- Përvojë të dëshmuar në angazhime të ngjashme
- Shkathtësi të mira analitike dhe të dokumentimit/raportimit
- Shkathtësi të mira të komunikimit dhe fasilitimit
- Shkathtësi të shkëlqyeshme të folurit dhe shkrimit në gjuhën Shqipe dhe Angleze
- Ndjeshmëri kulturore dhe ndaj aftësisë së kufizuar.

6. Kohëzgjatja e angazhimit

Kohëzgjatja e angazhimit llogaritet të jetë jo më shumë se 6 ditë, 4 ditë trajnim (në dy faza brenda periudhës 6 mujore) dhe 2 ditë përgatitore për hartimin e shabllonit dhe mbështetjen e OPAK-ve për

hartimin e planit për punë në media. Angazhimi pritet të realizohet gjatë periudhës Shkurt – Qershor 2022 (bazuar në marrëveshjen e përbashkët për datën specifike).

7. Produktet kryesore:

Eksperti do të punojë ngushtë me ekipin e projektit të HANDIKOS. Të gjitha produktet do t'i dorëzohen ekipit të projektit në datën e caktuar gjatë takimit koordinues. Raportet do të shqyrtohen nga HANDIKOS dhe partnerët e projektit. Të gjitha draft-dokumentet do të dorëzohen në formë elektronike, ndërsa produktet përfundimtare do të dorëzohen në formë elektronike dhe në kopje të printuara. Eksperti duhet të dorëzoj produktet e mëposhtme:

- Prezantimi në Powerpoint dhe/ose materialet tjera që do përdoren për qëllime të trajnimit
- Agjenda e trajnimit katër-ditor e ndarë në dy trajnime dy ditore
- Plani i detajuar i programit trajnues
- Shablloni i planeve të punës në media për OPAK që do marrin pjesë në trajnim
- Raporti i trajnimit

8. Buxheti për angazhimin

Buxheti i planifikuar për angazhimin e ekspertit është 150.00 Euro për ditë, apo 900.00 euro total për 6 ditë (3 ditë * 150 Euro= 450.00 Euro * 2 phases= 900 Euro).

Projekti do mbuloj koston financiare për sallën, ushqimin dhe pijet, materialet e trajnimit dhe aspektet tjera logjistike të punëtorisë.

Pagesa do realizohet pas dorëzimit të raportit të trajnimit! Departamenti i Financave do të zbrësë kontributet tatimore dhe pensionale në bazë të legjislacionit tatimor të Kosovës.

9. Datat tentativë dhe vendi

Datat tentativë: Shkurt 2022 (faza e parë) – Qershor 2022 (faza e dytë) bazuar në marrëveshjen e përbashkët.

Vendi: Të përcaktohet sipas masave të COVID 19.

10. Procedurat për aplikim

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme deri më 31 Janar 2022, ora 17:00.

- CV-në e përditësuar (Maksimum 3 faqe)
- Një draft propozim mbi metodologjinë e punës dhe konceptin e trajnimit, si dhe me informatat kontaktuese.

Aplikacionet duhet të dorëzohen vetëm në formë elektronike në email adresën: handikos@handi-kos.org dhe cc: dukagjin.kelmendi@handi-kos.org me subjektin APLIKIM PËR TRAJNIMIN “PËRDORIMI I MEDIAS NË AVOKIM”.

Vetëm kandidatët e listës së ngushtë do të kontaktohen.